

Për: Komisionin e Pavarur të Mediave  
Nga: Rrjeti Ballkanik për Gazetari Hulumtuese  
Subjekti: Komente për në lidhje me rishikimin dhe plotësimin e Kodit të Sjelljes  
për Shërbimet Audio Vizuele.  
Data: 24 dhjetor 2013

---

Të nderuar,

Ju lutem gjeni të bashkangjitur komentet e Rrjetit Ballkanik për Gazetari Hulumtuese, BIRN, për draft kodin e sjelljes për shërbimet audio vizuale.

Ju lusim që të na informoni me shkrim për vendimin tuaj lidhur me komentet tona.

Çdo të mirë,

Flutura Kusari  
Këshilltare Ligjore  
BIRN



The image shows a handwritten signature in blue ink that reads 'F. Kusari'. Overlaid on the signature is a blue rectangular stamp with the BIRN logo and text: 'BIRN BALKAN INVESTIGATIVE REPORTING NETWORK' and 'Rrjeti Ballkanik për Gazetari Hulumtuese'.



KKPM-2013/07

Në mbështetje të Nenit 3.2.6 të Ligjit Nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Medieve (Ligjit për KPM-në), KPM nxjerr:

## KODI I SJELLJES PËR SHËRBIMET MEDIALE AUDIO – VIZUELE

### NENI 1 QËLLIMI

Kodi i sjelljes ka për qëllim përcaktimin e rregullave të sjelljes dhe të punës së shërbimeve mediale audio-vizuele në pajtim me dispozitat ligjore që janë të domosdoshme në një shoqëri demokratike, për interesa të sigurisë kombëtare, të integritetit territorial dhe të sigurisë publike, për parandalimin e trazirave dhe të krimit; për mbrojtjen e shëndetit dhe të moralit, për mbrojtjen e fëmijëve, për mbrojtjen e prestigjit dhe të drejtave të tjerëve, për parandalimin e zbulimit të informatave të dhëna në besim, ose për ruajtjen e autoritetit dhe të paanësisë së drejtësisë.

### NENI 2 FUSHËVEPRIMI

1. Veprimtaria e shërbimeve mediale audio-vizuele nuk lejohet të cenojë rendin kushtetues, sovranitetin dhe integritetin kombëtar.
2. Të gjitha shërbimet mediale audiovizuele të licencuara nga KPM, pavarësisht mënyrës së transmetimit, duhet t'i përmbahen dispozitave të këtij Kodi.
3. Shërbimet mediale audio-vizuele do të respektojnë parimin e informimit të lirë dhe do të sigurojnë informata të sakta, me kohë, të vërteta, të qëndrueshme, të plota, të balancuara dhe të paanshme.
4. Shërbimet mediale audio-vizuele përmes transmetimit të programeve të tyre nuk do të inkurajojnë apo nxisin, qëllimisht ose tërthorazi, asnjërin prej formave të diskriminimit, jo tolerancës, gjuhën e urrejtjes, pabarazisë dhe dhunën në të gjitha format e saja.

5. Shërbimet mediale audio-vizuele nuk do të transmetojnë asnjë material që njollosë një grup etnik ose fetar, ose që lë të kuptohet se një grup etnik apo fetar është përgjegjës për aktivitet kriminal.
6. Shërbimet mediale audio-vizuele nuk do të transmetojnë asnjë material që nxitë apo inkurajon krimin ose aktivitete kriminale, ose që përmban në vete rrezikun e shkakimit të dëmit, që mund të jetë vdekje, lëndim, dëmtim i pronës apo ndonjë formë tjetër e dhunës.
7. Veprimtaria e shërbimeve mediale audio-vizuele respekton paanshmërisht të drejtën për informim, bindjet politike e besimet fetare, personalitetin, dinjitetin, jetën private të njeriut si dhe të drejtat e liritë themelore të tij.

### NENI 3 PËRKUFIZIMET

1. **Shërbimi medial audio-vizuel** – shërbimi i cili është nën përgjegjësinë editoriale të ofruesit të shërbimeve programore dhe parim kryesor i së cilës është ofrimi i programeve me qëllim që të informojnë, argëtojnë apo të edukojnë gjithë publikun përmes rrjeteve të komunikimeve elektronike.
2. **Ofrues i shërbimit medial** - personi fizik ose juridik i cili ka përgjegjësi redaktuese për përzgjedhjen e përmbajtjes audiovizuele të ofruesit të shërbimit medial dhe përcaktimin e mënyrës së organizimit të tij.
3. **Program** - një pako e fotografive lëvizëse me ose pa zë që përbën një njësi të vetme brenda orarit ose katalogjeve të programeve të vendosur nga ofruesi i shërbimit medial forma e të cilit është e krahasueshme me formën dhe përmbajtjen e transmetimit televiziv. Shembujt e programeve përfshijnë filmat e metrazhit të gjatë, ngjarjet sportive, komeditë, dokumentarët, programet për fëmijë dhe dramat origjinale.
4. **Përgjegjësia redaktuese** – ushtrimi i kontrollit efektiv mbi përzgjedhjen e programeve dhe mjeteve për ushtrimin e kontrollit efektiv mbi përzgjedhjen dhe organizimin e tyre në radhitje kronologjike në rastin e transmetimit televiziv, ose në katalog në rastin e shërbimit medial audiovizuel në bazë të kërkesës.
5. Paanëshmëri – nënkupton mosfavorizimin e njërës apo tjetrës palë.
6. Çështje e interesit publik - nënkupton çdo çështje e cila është në interes të publikut të publikohet duke përfshirë por duke mos u kufizuar në çështjet që kanë të bëjnë me të gjitha degët e pushtetit, politikë, shëndetësi dhe siguri publike, zbatim të ligjit, administrim të drejtësisë, interes të konsumatorëve dhe interes shoqëror, ambient, çështje ekonomike, ushtrim të pushtetit, shkencë, art dhe kulturë.

Flutura Kusari 24/12/13 11:36

**Comment [1]:** Definicioni bazohet ne ligjin civil kunder shpifjes dhe fyerjes.

### NENI 4 DALLIMI NDËRMJET LAJMIT DHE OPINIONIT



1. Derisa janë të lirë t'i shprehin mendimet e veta, shërbimet mediale audio-vizuele janë të obliguara që të bëjnë dallim të qartë ndërmjet lajmit dhe opinionit.
2. Lajmi nënkupton informacion të përbërë nga faktet dhe të dhënat, kurse opinionit bart mendime, ide, besime, supozime, komente apo gjykime vlerësuese nga ana e shërbimeve mediale audio-vizuele.
3. Opinionit i duhet të jetë shprehur me qëllim të mirë dhe të jetë i bazuar në ndonjë fakt.

#### NENI 5

#### VERIFIKIMI I FAKTEVE DHE RAPORTIMI I TË VËRTETËS

1. Shërbimet mediale audio-vizuele nuk do të transmetojnë material derisa nuk e bëjnë kërkimin rutinor dhe të arsyeshëm për të siguruar saktësinë, vërtetësinë dhe qëndrueshmërinë e tij.
2. Shërbimet mediale audio-vizuele nuk do të transmetojnë material të pavërtetë apo mashtrues.
3. Shërbimet mediale audio-vizuele kanë obligim profesional që t'i njoftojnë dhe t'i korrigojnë gabimet menjëherë. Përmirësimi i gabimeve duhet të bëhet në kohë të përshtatshme dhe të pranueshme.
4. Shërbimet mediale audio-vizuele nuk duhet të bëjnë plagjiaturë dhe duhet t'i referohen dhe të theksojnë në mënyrë të saktë burimin e informatës që është publikuar diku tjetër.

#### NENI 6

#### RAPORTIMI I DREJTË DHE I PAANSHËM

1. Shërbimet mediale audio-vizuele do të sigurojnë korrektësi, drejtësi dhe paanshmëri në të gjitha raportimet.
2. Shërbimet mediale audio-vizuele do të sigurojnë prezantimin e këndvështrimeve të ndryshme në mënyrë korrekte dhe të drejtë. Nëse njëra palë refuzon të ofrojë këndvështrimin e vet, publikuesi gjatë raportimit duhet ta theksojë këtë fakt, mirëpo duhet të sigurohen në raportimin e vërtetë të gjendjes faktike.
3. Shërbimet mediale audio-vizuele duhet të mbështeten në burime të identifikueshme të informacioneve dhe obligohen të mbrojnë identitetin e atyre të cilët ofrojnë informacione në konfidencë, pavarësisht nëse kjo është kërkuar paraprakisht apo jo.
4. Mbrojtja e burimeve duhet të bëhet në përputhje me ligjin nr. 04/L-137 për Mbrojtjen e Burimeve të Gazetarisë.
5. Gjatë raportimit dhe komentimit të një ngjarjeje kontraverse, duke iu shmangur supozimeve, shërbimet mediale audio-vizuele paraprakisht do t'i kontrollojnë faktet si

